



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:227233  
Datë: 15.03.2024  
Numri i dokumentit: 05458495

**C-IV-13-3975**

**Paditësit:** M P, Kamenicë.

**kundër**

**E paditura :** N.SH “ Qendresa ” (në likuidim), e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit,(AKP) Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtaren Ganimete Puka, me datë 15.03.2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar padia e paditësit, dhe **NDRYSHOHET** vendimi i AL, nr. GJI 101-0140, të datës 22.11.2013,
- II. **OBLIGOHET** Agjensioni Kosovar i Privatizimit ( AKP)– Autoriteti i Likuidimit të N.SH- , Qendresa,, ( në likuidim), që në emër të dëmshpërblimit për ndërprerjeje të marrëdhënies së punës me dhunë , për periudhën 15.tetor. 1990 deri Qershor 1999 , paditësit M P t’ia paguaj shumën prej 4.590.05 €, ( katër mijë e pesëqindën e nëntëdhjetë euro e pesë centë ) .
- III. **REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesës në lartësi prej 12.393.00 € , ( dymbëdhjetëmijë e treqindnëntëdhjetë tri euro ,) **si e pa bazuar.**
- IV. **SHUMA** e aprovuar si në pikën II të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- V. **Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.**

## **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Më 26 dhjetor. 2013, paditësi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, parashtrësë lidhur me Vendimit nr. GJI 101-0140, të datës 22.11.2013, të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) më të cilin ka kërkuar, që të detyrohet e paditura, që në emër të dëmshtëpërblim për ndërprerje të marrëdhënies së punës me dhunë, për periudhën 15.tetor.1990 - qershor 1999, në shumën bruto prej 18.585.75 €, apo shumën neto prej 14.189.50 €. Ankuesi e kundërshton vendimin e AL dhe thekson se kërkesa e tij ka të bëjë me kompensim për ndërprerje të parakohshme të punës në N.SH. Ka theksuar se ai ka qenë punëtor në N.SH “ Morava” tani Nsh. Qendresa, nga vitin 1982 deri 15.10.1990, ku ju është ndërprerë marrëdhënia e punë me dhunë, pastaj ka vazhduar në vitin 1999, deri në ditën e privatizimit me 30.07.2007. Ai pohon se me kohe i është drejtuar gjykatës për ta realizuara te drejtën e tij dhe pastaj edhe AL, dhe posedon prova, për ti vërtetuar pretendimet e tij. I propozon Gjykatës, që ankesën e tij ta aprovoj në tersi si të bazuar.

Me datë 02.04.2021, paditësit ka dorëzuar një parashtrësë të trilluar si argument-plotësim shtesë, duke e sqaruar, periudhën nga momenti i largimin nga puna 1990 - 1999, që i ka kërkuar të drejtat e tij ligjore, si dhe duke ju referuar provave material të dorëzuar së bashku me këtë parashtrësë.

Paditësit si i pa kënaqur, me Vendim e AL, kërkoj nga gjykata aprovimin e kërkesë së tij si të bazuar në prova dhe ligj, së bashku me parashtrësë ka dorëzuar :Vendimin e Këshillit te punëtoveve NTSH. Morava nr.512, të datës 12.10.1990, Vendimin e Këshillit të punëtoveve nr.714 datë 12.10.1990, ankesën drejtuar Gjykatës themelor të Punës së Bashkuar në Gjilani, datë 29.10.1990, aktgjykimin e Gjykatës komunale C.nr.176/2005, aktvendimin e Gjykatë së Qarkut në Gjilan AC.nr.69/2006,dt.18.07.2006, Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.241/2006 dt.31.10.2007, ekspertizën gjyqësorë C.nr.176/05 dt.20.01.2006, kërkesën për realizimin e të ardhurave personale për periudhën 15.10.1990 deri me datë 30.06.1999., sipas pagës mujor të realizuar nga N.SH. Qendresa nga 175 €, në shumen prej 18.585.€. Vendimin e AKP GJI01-0140,dt.22.11.2013, numër të protokollit nr.2480/13, Vendimin e AKP GJI01-0141, dt 24.12.2013. nr. të protokollit nr.6003/13-, nr.5, formularin për paraqitjen e kërkesë në 21.03.2011, 2480/13, specifikacionit i të ardhurave personale, dt.13.12.2013, vendimin për pushimin nga puna nr.714, dt.12.10.1990, Lista e punëtoveve që i kanë plotësuar kushtet për 20 %, dt.22.korri.2011 kërkesa ankuesit e dt.09.08.2011, Letër konfirmim i AKP, dt 08.07.2022, vërtetimin për realizimin e të ardhurave nr.38/20.01.2004, lëshuar nga N.SH Qendresa.

Me 07.09.2018, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje në ankesë, ku pohoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e ankuesit të paraqitura në ankesë duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohen. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e pa bazuar dhe së nuk dihet a është padi apo ankesë dhe parashtruesi nuk ka kërkuar anulimin e Vendimit të AL, dhe AL e ka shqyrtuar kërkesën e paditësit, dhe ka nxjerr vendimin nr.GJ101-0141, dt.24.12.2013. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Me 05 dhjetor 2018, përfaqësuesi i autorizuari i paditësit, ka dhënë përgjigje ndaj mbrojtjes së APK, dhe ka shtuar se AKP në mbrojtjen e saj vetëm ka ripërsëritur fjalë për të shfrytëzuar një të drejt të saj në mbrojtje, pa argumente dhe prova, dhe i ka propozua gjykatës, që ta aprovon kërkesën, dhe paditësit ti pranohet përvoja e punës për 25 vite 1 muaj dhe 15 ditë, dhe ta obligoj

AKP, në kompensimin e të ardhurave personale në lartësi prej 16.983.00€ të porealizuar për shkak të vendimit të kundërligjshmen dhe arbitrar dhe kontributet dhe tatimin në të ardhurat personale.

Me 16 Tetor.2018, e paditura AKP , në kundërpërgjigje e saj, ka mbet pranë mbrojtëses , dhe ka kundërshtuar në tersi ankesën/padinë e paditësit me pretendim se paditësi nuk ka dorëzuar prova, dëshmi, vetëm e ri përsërit propozimin që të detyrohet e paditura AKP, dhe ta miratoj kërkesën e Paditësit. I ka propozua gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tersi si të pa bazua.

Pala paditëse me parashtrësën e datës 02.06.2021, e tërheq autorizimin avokatit të tij, dhe jep arsyet sikur në ketë parashtrësë, duke i ripërsëritur pretendimet e tij.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtrësave të palëve.

### **Arsyetimi ligjor:**

Padia e paditësit aprovohet pjesërisht si e bazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Gjykata gjen se Agjencia Kosovare e Privatizimit – AL më rastin e vendosjes së kërkesës të parashtruesit për dëmshpërblim për largim nga puna pa bazë ligjor ( Formulari i kërkesës nr.0139, dt.21.03.2011), fillimisht me vendimin nr.2480/13- dt.22.11.2013, ka refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës , pastaj me vendimin tjetër nr. nr.6003/13/ dt, dt.24.12.2013, pjesërisht kishte pranuar kërkesë e parashtruesit , dhe nga shuma e kërkuar , prej 16.983.00 €, ( 1990-1999), palës ia kishte pranuar shumën prej 1673.70 €, + 176.40 €, të arsyetuar sikur në ketë vendim, ndërsa kishte refuzuar shumën prej 142.80 €, pa dhënë ndonjë arsyetim , dhe vetëm i referohet aktgjykimit të Gjykatës Komunale C.nr.2176/2005, dt.27 .janar.2006.

Nga pohimet e Ankuesi , i njëjti ka realizuar shumën prej 1602.50€ nga AKP, dhe kjo rrethanë nuk është kontestuese, ndërsa kontestues është pjesa tjetër e kërkesës për dëmshpërblimi dhe se kjo pjesë e kërkesës ka apo nuk ka bazë ligjore për aprovim.

Ankuesi kërkon kompensimin shtesë në vlerë prej 16.983€, sipas specifikacionit të përpiluar personalisht vetë, dt 13.12.2013, duke u thirrur se Gjykata Supreme e Kosovës, e ka aprovuar Revizionin e tij, dhe e ka prish aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac.nr.69/2006, dt.18.07.2006 dhe aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë, C.nr.2176/2005,

dt.27.janar.2006, dhe çështja ka mbetur pa u zgjidhur , dhe me aktvendimin C.nr.88/08, dt 18.05.2011, është ndërprerë procedura, dhe kërkesa e tij ka mbet pa u shqyrtuar.

Me 31.03.2011, ankuesi kishte paraqitur kërkesën në AL për dëmshpërblim për largim nga puna pa bazë ligjore, duke kërkuar shumën prej 16.983.00, që është brenda afatit për paraqitjen e kërkesave tek AL. Gjykata konsideron si të drejtë procedurën e ndjekur nga ana e ankuesit kur i është drejtuar AL me kërkesën për dëmshpërblim, këtë e ka pohuar edhe AKP.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës se ankuesit , se nuk dihet e është ankesë apo padi dhe ankuese nuk është duke e kërkuar anulimi e vendimit AL.

Nga dëshmitë e lartcekura, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në N.SH “Morava”, tani NSH Qendresa(në likuidim) nga vitin 1982, deri në vitin 1990, kur ishte larguar nga punë pa bazë ligjor.( vendimi nr.714/ 12.10.1990 për pushim të marrëdhënies së punës), ndaj të cilit vendim paditësi kishte ushtruar padi në gjykatën komunale në Kamenicë, dhe mban shenjen C.nr. 152/96, e aktivizuar në vitin 2005, dhe merr numër C.nr.176/05. Me aktgjykimin e Gjykatës komunale në Kamenicë, ishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadija e paditësit, duke ia pranuar shumën prej 1602.5 €, dhe e kishte refuzuar shumën prej 16.983.00 €, i cili aktgjykim ishte vërtetuar nga Gjykata e Qarkut në Gjilan, me aktvendimin Ac.nr. 69/06, dt.18.07.2006, ndërsa ishin prishur dy aktgjykimet e shkallës me të ultë, sipas revizionit të paditësit, më aktvendimin e gjykatës Suprem të Kosovës, Rev.nr. 241/2006, dt.14.06.2007, dhe me aktvendimin C.nr.88/06, të datës 18.05.2011, të GJK- Kamenicë, ishte ndërprerë procedura, dhe ishte udhëzuar pala për ti realizuar të drejta e tij ligjor në AKP-zyra në Gjilan.

Gjykata gjënë se AKP, me vendimin e kontestuar e kishte pranuar kërkesën e paditësit në shumën prej 1.673.70 €, në përputhje me nenin 40.1.6.1 dhe nenin 40.1.7, të shtojcë së Ligjit nr.04/L-034 të ligjit të AKP, si dhe shumen prej 176.40, në pajtim me dispozita e nenin 38.1 të Ligjit nr.03-L-161, për tatimi në të ardhurat personale, ndërsa kishte refuzuar shumën prej 142.80 si të pavlefshëm, ndërsa në arsyetim thirret, sipas aktgjykimin të Gjykatës Komunale e Kaçanik, ndërsa vendim fare nuk përmban arsye për pjesën e refuzuar, dhe çuditërisht në pasuesi e parë të vendimit AL, i referohet shumës së kërkuar nga paditësi në vlerë prej 1904.30 €, për periudha 15.tetor.1990- 30.qershor1999, pra gjykata gjënë se AL fare nuk e ka shqyrtuar dosjen e paditësit, sepse paditësit në vazhdimësi kishte kërkuar shumën bruto pagë 18.585.57€, apo neto pagë në vlerë prej 16.983 €, për periudhën tetor.1990 deri në Qershor 1999, ( formulari i plotësuar nga paditësi i dorëzuar në AKP, datë 27.03.2011, për shumën neto pagë 16.983.00€).

Baza ligjore për dëmshpërblim për shkak të largimit pa bazë ligjor , gjen mbështetje ligjor në Neni 40.1.6. nenin paragrafi 1.6.1. nenin 42.1, 2. i shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në, i cili parasheh që punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës nëse “ *janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në* ”. Privatizimi është një ndër veprimet e AKP-së të parapara me nenin 6.2.1 të Ligjit për AKP-në, prandaj kërkesa për dëmshpërblim e ankuesit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës është vlefshme dhe e bazuar.

Me rastin e aprovimit të shumës prej 4.661.70 € ( katër mijë e gjashtëqindën e gjashtëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë centë ) Gjykata , e mbështet në ekspertizën gjyqësorë financiare , C.nr.176/05, e punuar nga eksperti financiar Mr.sc.R R, dt.20.01.2006, ku rezulton si e provuar se kompensimi për paga të pa paguar paditësit ia takojnë në shumën prej 5.262.20 €, me kamatën ligjore prej 1001.55 €, në total shumën prej 6.263.75€, duke zbritur shumën e pranuar nga AL, në vlerë prej 1673.70€, paditësit i gjykohet shumën prej 4590.05 €, dhe nga shkresat e lëndës , gjykata ka vërtetuar se paditësi ishte larguar nga puna pa bazë ligjore, dhe kjo rrethanë fare nuk ka qenë kontestuese , kontestuar ka qenë vetëm lartësia e dëmit të pësuar , dhe kjo ishte vërtetuar me ekspertizë financiare , ashtu që paditësit i takon shpërblimi i dëmit në lartësinë e të ardhurave të cilat do ti kishte realizuar sikur të ishte në vendin e punës, për çka u vendos sikur në pjesën aprovuese të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, dhe provave në shkresat e lëndës, gjykata vjen në përfundim se pala paditëse , ishte punëtorë i NSH-së në kohën e privatizimit të saj dhe i takon e drejta në dëmshpërblim për largim nga punuar pa bazë ligjore, në shumën e aprovuar.

Gjykata ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesës së paditësit, e përfshirë në ekspertizën financiare për kompensimin e regresit shumën prej 635.55 €, dhe kompensimin për shujta në vlerë prej 2.090.00€, në total shumën prej 2.725.55 €, pasi që ka konsideruar së në rastin konkret paditësi nuk ka punuar për këtë periudhe kohore andaj regresi dhe shujtat, nuk kanë bazë ligjor për aprovim.

Gjykata ka refuzuar edhe pjesën tjetër të kërkesës së paditësit përtej ekspertizës financiare të kërkuar pasi që ka vlerësuar së një kërkesë e tillë është e pa bazuar, dhe është në kundërshtim të plotë me ekspertizën financiare, dhe nga arsyet e elaboruar si me lartë, kjo pjesë e kërkesës u refuzuar . Për gjykatën është e paqartë se në çka e bazon paditësi shumën përtej pjesës aprovuese, cila pjesë e ekspertizë financiar është kontestuar nga paditësi , deri sa ekspertiza financiare për gjykatën është shumë e qartë dhe arsyetuar mirë dhe ishte bazuar në mesataren e kursit për vit, muaj, në DM 336.14 DM, dhe konvertuar në euro në vlerën prej 172.00€, me çast edhe vendimi i gjykatës u pranuar për pjesën e aprovuar, si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurisë, se paditësi nuk është duke e kërkuar anulimin e vendimit të AL, dhe nuk po dihet a kemi të bëjmë me ankesë apo padi, për gjykatën një pretendim i tillë nuk ka vend për arsyetim , paditësi ka arrit ta bindë gjykatën me pretendimet dhe kërkimet e tij , si ish punëtor NSH, dhe që nga dita e largimit të tij nga puna si ish NSH Morava , dhe në të gjitha instancat gjyqësorë kishte kërkuar të drejtën e tij ligjor , dhe këtë e ka pas të njohur edhe vetë e paditura, andaj edhe kërkesa e paditësit është aprovua, si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të

Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi ka paguar taksës gjyqësore për padi.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

### **G j y q t a r e**

---

Ganimete Puka